



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2025

V E N D I M

Nr. _____, datë ____ . ____ .2025

**PËR
MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT RREGULLORE “PËR
INSPEKTIMIN E VEPRIMTARISË SË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE
SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 14 nëntor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 181 e vijues i ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për këshillim publik: Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit,

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Rregullorja e re për inspektimin është hartuar në përputhje me përcaktimet e reja të neneve 181-185 të ligjit nr. 54/2024 dhe ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
3. Dokumenti për këshillim publik: Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”
 - është një dokument rregullator i përgatitur në kuadër të hartimit nga AKEP të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 54/2024;
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 181 e vijues të ligjit nr. 54/2024 dhe ligjin nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024, dhe Rregullores “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi, do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti, bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentin Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Procedura e këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 më poshtë.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave, Kontrollit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka